



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

PROJEKTLIGJ PËR MBROJTJE NGA RREZATIMI DHE SIGURI BËRTHAMORE¹

DRAFT LAW ON RADIATION PROTECTION AND NUCLEAR SAFETY²

NACRT ZAKONA O ZAŠTITI OD ZRAČENJA I NUKLEARNA SIGURNOST³

¹Projektligjit për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore, është miratuar në mbledhjen e 17 të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin nr. 04/17, date 04.12.2017.

²Draft Law on Radiation Protection and Nuclear Safety, was approved on the 17 meeting of the Government of Kosovo, with the decision no. 04/17, 04.12.2017.

³Nacrt Zakona o Zaštiti od Zračenja i Nuklearna Sigurnost, usvojen je na 17 sednicu Vlade Kosova, sa odlukom br. 04/17, datum 04.12.2017.

<p>Kuvendi i Republikës së Kosovës,</p> <p>Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton:</p> <p>LIGJ PËR MBROJTJE NGA RREZATIMI DHE SIGURI BËRTHAMORE</p> <p>KAPITULLI I - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</p> <p style="text-align: center;">Neni 1 Qëllimi</p> <p>1.Qëllimi i këtij Ligji është të mbrojë shëndetin e njerëzve dhe mjedisin nga efektet e dëmshme të rrezatimit, dhe të sigurojë nivel të lartë të sigurisë bërthamore dhe të përmbushë detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës në këtë fushë.</p> <p>2.Ky Ligj është në përputhshmëri me direktivat e BE-së, me theks të veçantë: Direktivën për Standardet Bazë të Sigurisë (Direktiva 2013/59/EURATOM), Direktivën për Mbetjet Radioaktive dhe Menaxhimine Lëndës Djegëse të Shpenzuar (Direktiva 2011/70/EURATOM), Direktivën për Ujin</p>	<p>Assembly of the Republic of Kosovo,</p> <p>Pursuant to the Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,</p> <p>Approves:</p> <p>LAW ON RADIATION PROTECTION AND NUCLEAR SAFETY</p> <p>CHAPTER I - GENERAL PROVISIONS</p> <p style="text-align: center;">Article 1 Aim</p> <p>1. The objective of this Law is to protect the health and safety of people and the environment against the dangers arising from radiation, and to assure high level of nuclear safety and to fulfil the Republic of Kosovo international obligations in this area.</p> <p>2.This Law is in accordance with the EU directives, with special emphasis on: the Directive on Basic Safety Standards (Directive 2013/59/EURATOM), the Directive on Radioactive Waste and Spent Fuel Management (Directive 2011/70/EURATOM), the Directive on Water Intended for Human Consumption</p>	<p>Skupština Republike Kosova,</p> <p>Na osnovu člana 65 (1) Ustava Republike Kosova,</p> <p>Usvaja:</p> <p>ZAKON O ZAŠTITI OD RADIJACIJE I NUKLEARNE BEZBEDNOSTI</p> <p>POGLAVLJE I - OPŠTE ODREDBE</p> <p style="text-align: center;">Član 1 Cilj</p> <p>1.Cilj ovog zakona je da zaštiti zdravlje i bezbednost ljudi i životne sredine od opasnosti koje proizilaze iz zračenja i da obezbedi visok nivo nuklearne sigurnosti i da ispunji međunarodne obaveze Republike Kosovo u ovoj oblasti.</p> <p>2.Ovaj zakon je u skladu sa direktivama EU, sa posebnim naglaskom na sledeće: Direktiva o osnovnim bezbednosnim standardima (Direktiva 2013/59/EURATOM), Direktiva o radioaktivnom otpadu i rukovanju korišćenim gorivom (Direktiva 2011/70/EURATOM), Direktiva o vodi</p>
--	---	--

<p>për Konsum Njerëzor (Direktiva 2013/51/EURATOM), Direktivën për Transportin e Mbetjeve Radioaktive dhe Lëndës Djegëse të Shpenzuar (Direktiva 2006/117/EURATOM) dhe Direktivën për Sigurinë Bërthamore të Instalimeve Bërthamore me ndryshimet (Direktiva 2014/87/EURATOM).</p>	<p>(Directive 2013/51/EURATOM), the Directive on Shipments of Radioactive Waste and Spent Fuel (Directive 2006/117/EURATOM), and the Directive on Nuclear Safety of Nuclear Installations with amendments (Directive 2014/87/EURATOM).</p>	<p>namenjenoj za ljudsku potrošnju (Direktiva 2013/51/EURATOM), Direktiva o transportu radioaktivnog otpada i korišćenog goriva (Direktiva 2006/117/EURATOM) i Direktiva o nuklearnoj bezbednosti nuklearnih postrojenja sa amandmanima (Direktiva/2014/87/EURATOM).</p>
<p style="text-align: center;">Neni 2 Fushëveprimi</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 Scope</p>	<p style="text-align: center;">Član 2 Delokrug</p>
<p>1.Ky Ligj përcakton masat mbrojtëse për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe mjedisit nga ndikimi i dëmshëm i rrezatimit, masat e sigurisë bërthamore gjatë veprimeve lidhur me aktivitetet bërthamore, menaxhimin e mbetjeve radioaktive, mbikëqyrjen e zbatimit të masave, detyrimet ligjore të ndërmarrjeve që ushtrojnë praktikat.</p>	<p>1. This Law establishes protective measures for the lives and health of people and the environment from the harmful effects of radiation, nuclear safety measures during actions related to nuclear activities, radioactive waste management, supervision of the implementation of measures, legal obligations of undertakings performing practices.</p>	<p>1.Ovaj zakon postavlja zaštitne mere za živote i zdravlje ljudi i životne sredine od štetnih dejstava radijacije, mere nuklearne sigurnosti tokom akcija koje se odnose na nuklearne aktivnosti, upravljanje radioaktivnim otpadom, nadgledanje sprovođenja mera, zakonske obaveze preduzeća koja obavljaju delatnost.</p>
<p>2.Ky Ligj përcakton statusin, detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë së Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe për Siguri Bërthamore, përgjegjësinë për të komunikuar me shtetet tjera dhe organizatat ndërkombëtare relevante dhe përgjegjësitë për të arritur objektivat e përcaktuara në këtë Ligj.</p>	<p>2. This Law establishes the status, duties and responsibilities of the Kosovo Agency for Radiation Protection and Nuclear Safety responsibility for communication with other countries and international bodies and responsibilities for achieving the objectives stated in the purpose of the Law.</p>	<p>2.Ovaj zakon uspostavlja status, dužnosti i odgovornosti Kosovske Agencije za Zaštitu od Zračenja i Nuklearnu Sigurnost i odgovornost za komunikaciju sa drugim zemljama i međunarodnim telima i odgovornosti za ostvarivanje ciljeva navedenih kao svrha zakona.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 3 Përfshirjet nga fushëveprimi</p> <p>1.Ky Ligj nuk aplikohet për:</p> <p>1.1.Ekspozimin ndaj nivelit natyror të rrezatimit të tillë si radionukleidet që ndodhen në trupin e njeriut dhe rrezatimin kozmik që ndodhet në nivelin e tokës;</p> <p>1.2.Ekspozimin e pjesëtarëve të publikut ose punonjësve, përveçse ekuipazhit ajror, gjatë fluturimit;</p> <p>1.3.Ekspozimin mbi tokë ndaj radionukleideve të pranishme në koren e tokës së pashfrytëzuar.</p> <p>1.4.Aktivitetet ose praktikat të cilat përfshijnë ekspozimet e përfshiuara nga kontrolli rregullator.</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Exclusions from the scope</p> <p>1.This Law shall not apply to:</p> <p>1.1.Exposure to the natural level of radiation such as radionuclides contained in the human body and cosmic radiation prevailing at ground level;</p> <p>1.2.Exposure of members of the public or workers other than air crew to radiation in flight;</p> <p>1.3.Above ground exposure to radionuclides present in the undisturbed earth's crust.</p> <p>1.4.Activities or practices involving exposures that have been excluded from regulatory control.</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Izuzeca iz delokruga</p> <p>1.Ovaj zakon ne važi za sledeće:</p> <p>1.1.Izloženost prirodnom nivou radijacije kao što su radionukleidi sadržani u ljudskom telu i kosmička radijacija koja postoji na površini zemlje;</p> <p>1.2.Izloženost građana ili radnika radijaciji tokom letenja osim vazduhoplovaca.</p> <p>1.3.Nadzemna izloženost radionukleidima prisutnim u kori zemlje koja nije remećena.</p> <p>1.4.Aktivnosti ili prakse koje uključuju izloženost koje su izuzeti iz regulatorne kontrole.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 4 Përkufizimet</p> <p>1.Shprehjet e përdorura në këtë Ligj kanë këto kuptime:</p> <p>1.1.Aktivitet (A) - nënkupton aktivitetin e një sasive të një radionukleidi në një gjendje të caktuar të energjisë në një kohë të caktuar.</p>	<p style="text-align: center;">Article 4 Definitions</p> <p>1.The terms used in this Law have the following meanings:</p> <p>1.1. Activity (A) - the activity of an amount of a radionuclide in a particular energy state at a given time. The unit of</p>	<p style="text-align: center;">Član 4 Definicije</p> <p>1.Termini korišćeni u ovom zakonu imaju sledeće značenje:</p> <p>1.1.Aktivnost (A) – aktivnost određene količine radionukleida u određenom stanju energije u datom</p>

<p>Njësia e aktivitetit është bekerel (Bq);</p> <p>1.2.Aktivizim - nënkupton procesin nëpërmjet të cilit një bërthamë e qëndrueshme transformohet në radionukleid duke rrezatuar me grimca ose fotone me energji të lartë materialin në të cilin ndodhet;</p> <p>1.3.Aksident – nënkupton çdo ngjarje të paqëllimshme, pasojat ose pasojat e mundshme të së cilës janë të rëndësishme nga pikëpamja e mbrojtjes nga rrezatimi dhe sigurisë bërthamore;</p> <p>1.4.ALARA - nënkupton nivelin më të ulët të qëndrueshëm i cili arrihet në mënyrë të arsyeshme;</p> <p>1.5.ANEA – Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike;</p> <p>1.6.Autorizim – nënkupton regjistrimin ose liçensimin e një praktike;</p> <p>1.7.Burim jetim - nënkupton burimin radioaktiv i cili nuk është as i përjashtuar as nën kontrollin rregullator, sepse kurrë nuk ka qenë nën kontrollin rregullator ose për shkak se është braktisur, humbur,</p>	<p>activity is the becquerel (Bq);</p> <p>1.2.Activation - the process through which a stable nuclide is transformed into a radionuclide by irradiating with particles or high-energy photons the material in which it is contained;</p> <p>1.3.Accident- any unintended event, the consequences or potential consequences of which are significant from the point of view of radiation protection or nuclear safety;</p> <p>1.4.ALARA - As Low As Reasonably Achievable;</p> <p>1.5.IAEA - International Atomic Energy Agency</p> <p>1.6.Authorisation - registration or licensing of a practice;</p> <p>1.7.Orphan source - a radioactive source which is neither exempted nor under regulatory control, because it has never been under regulatory control or because it has been abandoned, lost, misplaced, stolen or otherwise</p>	<p>vremenu. Jedinica aktivnosti je Bekerel (Bq);</p> <p>1.2.Aktivacija – proces kroz koji se stabilan nukleid transformiše u radionukleid preko radijacije sa česticama visoko energetske fotona materija u kojem su sadržani;</p> <p>1.3.Akcident- bilo koji neplanirani događaj, čije posledice ili potencijalne posledice imaju značajne dimenzije sa tačke gledišta zaštite od radijacije i nuklearne sigurnosti;</p> <p>1.4.ALARA – (As Low As Reasonably Achievable) Što je niže razumno moguće ostvariti;</p> <p>1.5.MAAE – Međunarodna agencija za atomsku energiju</p> <p>1.6.Autorizacija – registracije ili davanje licence za delatnost;</p> <p>1.7.Napuštene izvor – radioaktivni izvor koji niti je izuzet niti potpada pod regulatornu kontrolu, zato što nikada nije bio pod regulatornom kontrolom ili zato što je bio napušten, izgubljen, pogrešno odložen, ukraden ili na drugi</p>
---	--	---

<p>keqvendosur, vjedhur ose transferuar pa autorizimin e duhur;</p> <p>1.8.Burim radioaktiv – nënkupton një burim rrezatimi i cili përmban material radioaktiv me qëllim të përdorimit të radioaktivitetit të tij;</p> <p>1.9.Burim i mbyllur – nënkupton një burim radioaktiv në të cilin materiali radioaktiv është i mbyllur përgjithmonë në një kapsulë ose i përfshirë në një formë solide me qëllim të parandalimit të çfarëdo shpërndarjeje të substancave radioaktive në kushte normale të përdorimit;</p> <p>1.10.Burim i mbyllur me aktivitet të lartë (HASS) - nënkupton një burim të mbyllur për të cilin aktiviteti i radionukleideve të përfshira është i barabartë ose tejkalon vlerën e aktivitetit përkatës të përcaktuar në rregulloren përkatëse;</p> <p>1.11.Burim i papërdorshëm - nënkupton një burim të mbyllur i cili nuk përdoret më ose nuk synohet të përdoret për praktikën për të cilën është dhënë autorizimi, por vazhdon të kërkojë menaxhim të sigurt;</p> <p>1.12.Burim i rrezatimit - nënkupton</p>	<p>transferred without proper authorisation;</p> <p>1.8.Radioactive source - a radiation source incorporating radioactive material for the purpose of utilising its radioactivity;</p> <p>1.9.Sealed source - a radioactive source in which the radioactive material is permanently sealed in a capsule or incorporated in a solid form with the objective of preventing, under normal conditions of use, any dispersion of radioactive substances;</p> <p>1.10.High-Activity Sealed Source (HASS) - a sealed source for which the activity of the contained radionuclide is equal to or exceeds the relevant activity value laid down in the relevant regulation;</p> <p>1.11.Disused source - means a sealed source which is no longer used or intended to be used for the practice for which authorisation was granted but continues to require safe management;</p> <p>1.12.Radiation source - a facility,</p>	<p>način prenet bez odgovarajuće autorizacije;</p> <p>1.8.Radioaktivni izvor - izvor radijacije koji sadrži radioaktivni materijal u svrhu korišćenja njegove radioaktivnosti;</p> <p>1.9.Zapečaćeni izvor - radioaktivni izvor u kojem je radioaktivni materijal permanentno zapečaćen u kapsuli ili postavljen u čvrstom obliku sa ciljem prevencije, pod uslovima normalnog korišćenja, bilo kakve disperzije radioaktivnih supstanci;</p> <p>1.10.Visoko aktivni zapečaćeni izvor (HASS) – zapečaćeni izvor za koji je aktivnost sadržanog radionukleida jednaka ili prevazilazi relevantnu vrednost aktivnosti postavljenu u relevantnoj uredbi;</p> <p>1.11.Nekorišteni zapečaćeni izvor - znači zapečaćeni izvor koji se više ne koristi ili se ne namjerava koristiti za delatnost za koje je dano ovlaštenje, ali i dalje zahtijeva sigurno upravljanje;</p> <p>1.12.Izvor radijacije- objekat, oprema ili radioaktivna supstanca koja može</p>
---	---	---

<p>një objekt, pajisje ose substancë radioaktive e cila mund të shkaktojë ekspozim përmes emetimit të rrezatimit ose përmes shkarkimit të materialit radioaktiv;</p> <p>1.13.Deponim - nënkupton mbajtjen e materialit radioaktiv, duke përfshirë lëndë djegëse bërthamore të shpenzuar, një burimi radioaktiv ose mbetje radioaktive, në një objekt pa qëllim të rikthimit;</p> <p>1.14.Dëm shëndetësor - nënkupton zvogëlim në gjatësinë dhe cilësinë e jetës që ndodh në një popullsi pas ekspozimit, duke përfshirë ato që rrjedhin nga reaksionet e indeve, kanceri dhe çrregullimi i rëndë gjenetik;</p> <p>1.15.Dozë e absorbuar (D) - nënkupton energjinë e absorbuar për njësi të masës;</p> <p>1.16.Dozë ekuivalente - nënkupton dozën e absorbuar në ind apo organ, e peshuar për llojin dhe cilësinë e rrezatimit;</p> <p>1.17.Ekspert i fizikës mjekësore - nënkupton një individ i cili ka njohuri, trajnim dhe përvojë për të vepruar ose</p>	<p>equipment or radioactive substance that may cause exposure, such as by emitting radiation or by releasing radioactive material;</p> <p>1.13.Disposal – the holding of radioactive material, including spent fuel, a radioactive source or radioactive waste, in a facility without the intention of retrieval;</p> <p>1.14.Health detriment - reduction in length and quality of life occurring in a population following exposure, including those arising from tissue reactions, cancer and severe genetic disorder;</p> <p>1.15.Absorbed dose (D) - the energy absorbed per unit mass;</p> <p>1.16. Equivalent dose - the absorbed dose, in tissue or organ weighted for the type and quality of radiation.</p> <p>1.17.Medical physics expert - an individual having the knowledge, training and experience to act or give</p>	<p>prouzrokovati izloženost kao npr. emitujući radijaciji ili ispuštajući radioaktivni materijal;</p> <p>1.13.Odlaganje – držanje radioaktivnog materijala uključujući i korišćeno gorivo, radioaktivni izvor ili radioaktivni otpad, u objektu bez namere ponovnog preuzimanja;</p> <p>1.14.Oštećenje zdravlja – smanjenje dužine i kvaliteta života koje se javlja kod stanovništva nakon izloženosti, uključujući i onu koja proističe iz reakcije tkiva, kancera i teških genetskih poremećaja;</p> <p>1.15.Apsorbovana doza (D) – energija koja je apsorbovana po jedinici mase;</p> <p>1.16.Ekvivalentna doza – apsorbovana doza u tkivu ili organu izmerena po vrsti i kvalitetu radijacije.</p> <p>1.17.Stručnjak za medicinsku fiziku – Lice koje poseduje znanje, obuku i iskustvo da deluje ili pruža savete o</p>
---	--	--

<p>dhënë këshilla mbi çështjet që lidhen me fizikën e rrezatimit të zbatuar në ekspozimin mjekësor, kompetenca e të cilit në këtë drejtim është njohur nga Agjencia;</p> <p>1.18. Ekspert i mbrojtjes nga rrezatimi - nënkupton një individ i cili ka njohuri, trajnim dhe përvojë të nevojshme për të dhënë këshilla të mbrojtjes nga rrezatimi për të siguruar mbrojtjen efektive të individëve, kompetenca e të cilit në këtë aspekt njihet nga Agjencia;</p> <p>1.19. Ekspozim - nënkupton aktin e ekspozimit ose gjendjes së të qenit i/e ekspozuar ndaj rrezatimit jonizues të emetuar jashtë trupit (ekspozim i jashtëm) ose brenda trupit (ekspozim i brendshëm);</p> <p>1.20. Ekspozim aksidental - nënkupton ekspozimin e individëve, në përjashtim të punonjësve të emergjencës, si rezultat i një aksidenti;</p> <p>1.21. Ekspozim emergjent në punë - nënkupton ekspozimin ndaj rrezatimit në një situatë emergjente të ekspozimit nga një punonjës emergjence;</p>	<p>advice on matters relating to radiation physics applied to medical exposure, whose competence in this respect is recognised by the Agency;</p> <p>1.18. Radiation protection expert - an individual having the knowledge, training and experience needed to give radiation protection advice in order to ensure the effective protection of individuals, and whose competence in this respect is recognised by the Agency;</p> <p>1.19. Exposure - the act of exposing or condition of being exposed to ionizing radiation emitted outside the body (external exposure) or within the body (internal exposure);</p> <p>1.20. Accidental exposure - the exposure of individuals, other than emergency workers, as a result of an accident;</p> <p>1.21. Emergency occupational exposure - exposure received in an emergency exposure situation by an emergency worker;</p>	<p>stvarima koje se odnose na fiziku radijacije primenjenu na medicinsku izloženost, čija stručnost u ovom pogledaju je priznata od strane Agencije;</p> <p>1.18. Stručnjak za zaštitu od radijacije – lice koje poseduje znanje, obuku i stručnost potrebne da se daju saveti o zaštiti od radijacije kako bi se obezbedila delotvorna zaštita ljudi, i čija stručnost u ovom pogledu priznata od strane Agencije;</p> <p>1.19. Izloženost – akt izlaganja ili stanja izloženosti jonizujućem zračenju emitovanom izvan tela (spoljna izloženost) ili unutar tela (interna izloženost);</p> <p>1.20. Akcidentalna izloženost – izloženost pojedinaca, osim radnika na hitnim slučajevima kao rezultat akcidenta;</p> <p>1.21. Vanredna profesionalna izloženost – izloženost dobijena u situacijama vanredne izloženosti kod radnika na vanrednim situacijama;</p>
--	--	---

<p>1.22.Ekspozim mjekësor - nënkupton ekspozimin e shkaktuar te pacientët ose individët asimptomatikë si pjesë e vetë diagnostikimit ose trajtimit të tyre mjekësor ose dentar, dhe në të mirën e shëndetit të tyre, si dhe ekspozimi i shkaktuar te kujdestarët dhe ndihmuesit si dhe nga vullnetarët në hulumtimet mjekësore ose biomjekësore;</p> <p>1.23.Ekspozim normal - nënkupton ekspozimin që pritet të ndodhë në kushte normale të operimit në një objekt ose aktivitet (përfshirë mirëmbajtjen, inspektimin, dekomisionimin) duke përfshirë incidente të vogla që mund të mbahen nën kontroll, pra gjatë operimit normal dhe ngjarjeve të parashikuara operative;</p> <p>1.24.Ekspozim profesional - nënkupton ekspozimin e punonjësve, praktikantëve dhe studentëve, të shkaktuar gjatë kryerjes së punës së tyre;</p> <p>1.25.Ekspozim publik - nënkupton ekspozimin e individëve, duke përjashtuar çdo ekspozim profesional apo mjekësor;</p>	<p>1.22.Medical exposure - exposure incurred by patients or asymptomatic individuals as part of their own medical or dental diagnosis or treatment, and intended to benefit their health, as well as exposure incurred by carers and comforters and by volunteers in medical or biomedical research;</p> <p>1.23.Normal exposure - exposure expected to occur under the normal operating conditions of a facility or activity (including maintenance, inspection, decommissioning), including minor incidents that can be kept under control, i.e. during normal operation and anticipated operational occurrences;</p> <p>1.24.Occupational exposure - exposure of workers, apprentices and students, incurred in the course of their work;</p> <p>1.25.Public exposure - exposure of individuals, excluding any occupational or medical exposure;</p>	<p>1.22.Medicinska izloženost – izloženost nastala kod pacijenta ili asimptomatskih pojedinaca kao deo njihovog medicinskog ili stomatološkog tretmana ili dijagnoze, sa namerom da se poboljša njihovo zdravlje, kao i izloženost koju su doneli staratelji i oni koji pružaju negu, kao i volonteri u medicinskim ili biomedicniskim istraživanjima;</p> <p>1.23.Normalna izloženost – izloženost za koju se očekuje da se pojavi pod normalnim radnim uslovima u objektu ili aktivnosti (uključujući i održavanje, inspekciju, dekomisioniranje), uključujući i manje incidente koji se mogu držati pod kontrolom tj. Tokom normalnog rada uz prihvatljive operative pojave;</p> <p>1.24.Profesionalna izloženost – izloženost radnika, pomoćnika i učenika, nastala tokom obavljanja posla;</p> <p>1.25.Javna izloženost – izloženost pojedinaca, isključujući bilo kakvu profesionalnu ili medicinsku izloženost;</p>
---	---	--

<p>1.26.Ekspozim i mundshëm - nënkupton ekspozimin që nuk pritet por mund të rezultojë nga një ngjarje apo sekuençë e ngjarjeve me natyrë gjase, duke përfshirë prishjen e pajisjeve ose gabimet gjatë punës;</p> <p>1.27.Ekspozimi në situatë ekzistuese - nënkupton një situatë të ekspozimit e cila ekziston në kohën kur duhet të merret një vendim për kontrollin e saj dhe e cila nuk kërkon ose tashmë nuk kërkon që të merren masa urgjente;</p> <p>1.28.Ekspozim në situatë emergjente – nënkupton një situatë ekspozimi për shkak të një emergjence;</p> <p>1.29.Emergjencë – nënkupton një situatë ose ngjarje jo-rutinore e cila përfshin një burim të rrezatimit që dikton marrjen e masave të menjëhershme për të lehtësuar pasoja të rënda negative për shëndetin dhe sigurinë njerëzore, cilësinë e jetës, pronës ose mjedisit, ose një rrezik që mund të shkaktojë pasoja të tilla serioze;</p> <p>1.30.Objekt – nënkupton një instalim bërthamor, instalim të rrezatimit, objekt minierash dhe përpunim të materialeve siç janë minierat e</p>	<p>1.26.Potential exposure - exposure that is not expected with certainty but may result from an event or sequence of events of a probabilistic nature, including equipment failures and operating errors;</p> <p>1.27.Existing exposure situation - an exposure situation that already exists when a decision on its control has to be taken and which does not call or no longer calls for urgent measures to be taken;</p> <p>1.28.Emergency exposure situation - a situation of exposure due to an emergency;</p> <p>1.29.Emergency - a non-routine situation or event involving a radiation source that necessitates prompt action to mitigate serious adverse consequences for human health and safety, quality of life, property or the environment, or a hazard that could give rise to such serious adverse consequences;</p> <p>1.30.Facility - nuclear installations, irradiation installations, some mining and raw material processing facilities such as uranium mines; radioactive</p>	<p>1.26.Potencijalna izloženost – izloženost koja se ne očekuje sa izvesnošću, ali može biti rezultat događaja ili niza događaja koji su verovatni, uključujući i kvarove opreme i greške u radu;</p> <p>1.27.Postojeće situacija izloženost – situacija izloženosti koja već postoji kada odluka o njenoj kontroli treba da se donese, koja ne zahteva ili ne zahteva više preduzimanje hitnih mera;</p> <p>1.28.Izloženost kao hitna situacija - situacija sa izloženošću zbog hitne vanredne situacije;</p> <p>1.29.Izvanredni događaj – situacija koja nije rutinska, kao i događaj, gde postoji izvor radijacije koji zahteva brzu akciju na ublažavanju ozbiljnih negativnih posledica po ljudsko zdravlje i bezbednost, kvalitet života, imovinu ili životnu sredinu, ili je rizik koji može dovesti do ovakvih ozbiljnih negativnih posledica;</p> <p>1.30.Objekat - nuklearne instalacije, instalacije iradijacije, neki objekti u vezi sa preradom ruda i sirovina kao što su rudnici uranijama; objekti za obradu</p>
---	--	---

<p>uraniumit, objekt menaxhimi të mbetjeve radioaktive, dhe çdo vend tjetër ku materialet radioaktive prodhohen, përpunohen, përdoren, trajtohen, magazinohen apo deponohen, në atë masë për të cilën kërkohet mbrojtje dhe siguri;</p> <p>1.31.Instalim bërthamor - nënkupton: (a) central bërthamor, impiant për pasurim, impiant për prodhim të lëndës djegëse bërthamore, impiant për ripërpunim, impiant reaktori hulumtues, impiant për magazinimin e lëndës djegëse të shpenzuar; dhe (b) impiant për magazinimin e mbetjeve radioaktive i cili gjendet në të njëjtin vend dhe lidhet direkt me impiantet bërthamore të listuara në pikën (a);</p> <p>1.32.Incident – nënkupton çdo ngjarje të paqëllimshme, pasojat ose pasojat e mundshme të së cilës nuk mund të neglizhohen nga pikëpamja e mbrojtjes nga rrezatimi dhe sigurisë bërthamore;</p> <p>1.33.Inspektim – nënkupton një hetim nga, ose në emër të Agjencisë për të verifikuar përputhshmërinë me kërkesat ligjore ndërkombëtare;</p> <p>1.34.Kontaminim - nënkupton praninë e paqëllimshme ose të padëshirueshme</p>	<p>waste management facilities; and any other places where radioactive material is produced, processed, used, handled, stored or disposed of, on such a scale that consideration of protection and safety is required;</p> <p>1.31.Nuclear installation - (a) a nuclear power plant, enrichment plant, nuclear fuel fabrication plant, reprocessing plant, research reactor facility, spent fuel storage facility; and (b) storage facilities for radioactive waste that are on the same site and are directly related to nuclear installations listed under point (a);</p> <p>1.32.Incident - any unintended event, the consequences or potential consequences of which are not negligible from the point of view of radiation protection or nuclear safety;</p> <p>1.33.Inspection - an investigation by or on behalf of the Agency to verify compliance with national legal requirements;</p> <p>1.34.Contamination - the unintended or undesirable presence of radioactive</p>	<p>radioaktivnog otpada; i bilo koja druga mesta gde se radioaktivni materijal proizvodi, obrađuje, koristi, rukuje, odláže ili odbacuje, u takvoj meri da se zahteva razmatranje mogućnosti zaštite i bezbednosti;</p> <p>1.31.Nuklearna instalacija - (a) nuklearna elektrana, postrojenje za obogaćivanje, fabrika za proizvodnju nuklearnog goriva, postrojenje za preradu, postrojenje za istraživanje reaktora, objekat za skladištenje korišćenog goriva; i (b) skladišni objekat za radioaktivni otpad koji se nalazi na istom mestu i direktno je povezan sa nuklearnim instalacijama navedenim pod tačkom (a);</p> <p>1.32.Incident – svaki nenamerni događaj, čije posledice ili potencijalne posledice nisu zanemarljive sa tačke gledište zaštite od radijacije ili nuklearne sigurnosti;</p> <p>1.33.Inspekcija – istraga od strane ili u ime Agencije kako bi se verifikovala usklađenost sa nacionalnim zakonskim uslovima;</p> <p>1.34.Kontaminacija – nenameravana ili neželjena prisutnost radioaktivnih</p>
--	--	---

<p>të substancave radioaktive në sipërfaqe ose brenda trupave të ngurtë, lëngjeve ose gazeve, ose në trupin e njeriut;</p> <p>1.35.Kontroll rregullator - nënkupton çdo formë të kontrollit ose rregullimit, të aplikuar në aktivitetet njerëzore për zbatimin e këtij Ligji;</p> <p>1.36.Kufi i dozës – nënkupton vlerën e dozës efektive (aty ku aplikohet, dozë efektive e përkushtuar), ose dozën ekuivalente në një periudhë të caktuar e cila nuk tejkalohet për një individ;</p> <p>1.37.Kufizim i dozës - nënkupton kufizimin i cili paraqet nivelin më të lartë të mundshëm për doza individuale, që përdoret për të përcaktuar një varg mundësish të cilat konsiderohen në procesin e optimizimit për një burim të caktuar të rrezatimit në një situatë të planifikuar të ekspozimit;</p> <p>1.38.Kujdestarë dhe ndihmës - nënkupton individë të cilët me vetëdije dhe vullnet i ekspozohen rrezatimit jonizues duke ndihmuar, përveç brenda profesionit të tyre, në mbështetjen dhe komoditetin e individëve që i</p>	<p>substances on surfaces or within solids, liquids or gases or on the human body;</p> <p>1.35.Regulatory control - any form of control or regulation applied to human activities for the enforcement of this Law;</p> <p>1.36.Dose constraint - a constraint set as a prospective upper bound of individual doses, used to define the range of options considered in the process of optimisation for a given radiation source in a planned exposure situation;</p> <p>1.37.Dose limit - the value of the effective dose (where applicable, committed effective dose) or the equivalent dose in a specified period which shall not be exceeded for an individual;</p> <p>1.38.Carers and comforters - means individuals knowingly and willingly incurring an exposure to ionizing radiation by helping, other than as part of their occupation, in the support and comfort of individuals undergoing or</p>	<p>supstanci na površinama ili unutar čvrstih materijala, tečnosti ili gasova ili u ljudskom telu;</p> <p>1.35.Regulatorna kontrola – bilo koji oblik kontrole ili regulisanja koji se primenjuje na ljudske aktivnosti radi sprovođenja ovog zakona;</p> <p>1.36.Ograničenja dolaze – ograničenje koje je postavljeno kao predviđanja gornja granica individualnih doza, koristi se za definisanje niza opcija uzetih u obzir optimizacije za dati izvor radijacije u situaciji planirane izloženosti;</p> <p>1.37.Limit doze – vrednost efektivne doze (gde je primenjivo, realizovana efektivna doza) ili ekvivalentna doza u konkretno preciziranom periodu koja ne sme da se prekorači za pojedinca;</p> <p>1.38.Njegovatelji i pomagači - znači osobe koje svjesno sam namerno pristaju na izlaganje ionizirajućem zračenju pomažući, izuzev u okviru svojeg Posla, U Potpori sam pružanju pomoći pojedincima koji se nalaze u</p>
--	---	--

<p>nënshtrohen ose i janë nënshtuar ekspozimit mjekësor;</p> <p>1.39.Lëndë djegëse e shpenzuar - nënkupton karburantin bërthamor që është rrezatuar dhe që hiqet përgjithmonë nga një bërthamë reaktori; karburanti i shpenzuar mund të konsiderohet si një burim i përdorshëm që mund të ri-përpunohet ose do të destinohet për asgjësim nëse konsiderohet si mbetje radioaktive;</p> <p>1.40.Licensë – nënkupton lejen e dhënë përmes një dokumenti nga Agjencia për të ushtruar një praktikë në pëpërputhshmëri me kushtet specifike të theksuara në atë dokument;</p> <p>1.41.Magazinimi - nënkupton mbajtjen e materialit radioaktiv, duke përfshirë lëndën djegëse bërthamore të shpenzuar, burimin radioaktiv ose mbetjen radioaktive, në një objekt me qëllim të rikthimit;</p> <p>1.42.Masa mbrojtëse - nënkupton masa, të ndryshme nga masat shëruuese, që kanë për qëllim të shmangin ose të zvogëlojnë dozat që ndryshe mund të pranohen në një situatë emergjente të ekspozimit ose në një situatë ekzistuese të ekspozimit;</p>	<p>having undergone medical exposure;</p> <p>1.39.Spent fuel - means nuclear fuel that has been irradiated in and permanently removed from a reactor core; spent fuel may either be considered as a usable resource that can be reprocessed or be destined for disposal if regarded as radioactive waste;</p> <p>1.40.Licence - permission granted in a document by the Agency to carry out a practice in accordance with specific conditions laid down in that document;</p> <p>1.41.Storage - the holding of radioactive material, including spent fuel, a radioactive source or radioactive waste, in a facility with the intention of retrieval;</p> <p>1.42.Protective measures - measures, other than remedial measures, for the purpose of avoiding or reducing doses that might otherwise be received in an emergency exposure situation or an existing exposure situation;</p>	<p>situacii or Su Prošli situaciju zdravstveno izlaganja zračenju;</p> <p>1.39. Korišćeno gorivo - znači nuklearno gorivo koje je ozračeno u jezgru reaktora i trajno uklonjen iz njega; korišćeno gorivo se može smatrati upotrebljivim izvorom koji se može ponovo preraditi ili se može koristiti za odlaganje ako se smatra radioaktivni otpad;</p> <p>1.40.Licenca – dozvola koja se dobija preko dokumenta Agencije radi obavljanja praktičnih aktivnosti u skladu sa konkretnim uslovima postavljenim u tom dokumentu;</p> <p>1.41.Skladište – držanje radioaktivnog materijala, uključujući i korišćeno gorivo, radioaktivnog izvora ili radioaktivnog otpada u objektu uz nameravani povraćaj;</p> <p>1.42.Zaštitne mere – mere osim popravnih mera, u svrhu izbegavanja ili smanjenja doza koje bi inače mogle biti dobijene prilikom izloženosti u vanrednim i hitnim situacijama ili u postojećim situacijama izloženosti;</p>
---	---	--

<p>1.43.Material bërthamor – nënkupton plutoniumin-239, uraniumin-233, ose uraniumin e pasuruar në izotopet uranium-233 ose uranium-235, ose çdo material tjetër për të cilin Agjencia vendos që duhet të klasifikohet si material bërthamor.</p> <p>1.44.Material ndërtimi - nënkupton çdo produkt ndërtimor për përfshirje të përhershme në një ndërtesë apo pjesë të saj, performanca e të cilit ka ndikim në performancën e ndërtesës sa i përket ekspozimit të banorëve të saj ndaj rrezatimit jonizues;</p> <p>1.45.Material radioaktiv – nënkupton një material i cili përmban substanca radioaktive;</p> <p>1.46.Mbetje radioaktive – nënkupton një material radioaktiv në formë të gaztë, të lëngët ose të ngurtë, përdorimi i mëtejshëm i të cilit nuk parashihet apo konsiderohet nga Agjencia ose nga një person fizik ose juridik, i cili rregullohet si mbetje radioaktive në këtë Ligj;</p> <p>1.47.Mbyllje - nënkupton përfundimin e të gjitha veprimtarive në një kohë pas vendosjes së lëndës djegëse të</p>	<p>1.43.Nuclear material - plutonium-239, uranium-233, or uranium enriched in the isotopes uranium-233 or uranium-235, or any other material the Agency determines should be classified as nuclear material.</p> <p>1.44.Building material - any construction product for incorporation in a permanent manner in a building or parts thereof and the performance of which has an effect on the performance of the building with regard to exposure of its occupants to ionizing radiation;</p> <p>1.45.Radioactive material - material incorporating radioactive substances;</p> <p>1.46.Radioactive waste - radioactive material in gaseous, liquid or solid form for which no further use is foreseen or considered by the Agency or by a legal or natural person whose decision is accepted by the Agency, and which is regulated as radioactive waste under this Law;</p> <p>1.47.Closure - means the completion of all operations at some time after the emplacement of spent fuel or</p>	<p>1.43.Nuklearni materijal - plutonijum-239, uranijum-233, ili uranijum koji je obogaćen izotopima uranijuma-233 ili uranijuma-235, ili bilo koji drugi materijal za koji Agencija odredi da treba da bude klasifikovan kao nuklearni materijal.</p> <p>1.44.Građevinski materijal – bilo koji građevinski proizvod za permanentno ugrađivanje u zgradu ili njihovi delovi čija primena ima dejstvo na učinak zgrade u pogledu izloženosti njenih korisnika jonizuju čem zračenju;</p> <p>1.45.Radioaktivni materijal - materijal koji sadrži radioaktivne supstance;</p> <p>1.46.Radioaktivni otpad – radioaktivni materijal u gasnom, tečnom ili čvrstom stanju za koji nije predviđena dalja upotreba ili ga razmatra Agencija ili drugo pravno ili fizičko lice čiju je odluka Agencija prihvatila, i koji je regulisan kao radioaktivan otpad shodno ovom zakonu;</p> <p>1.47.Zatvaranje - znači okončanje svih djelatnosti u određenom trenutku nakon postavljanja istrošenog</p>
---	---	---

<p>shpenzuar ose mbetjeve radioaktive në objekt të depozitimit, përfshirë punët përfundimtare inxhinierike ose punë të tjera të nevojshme për të sjellë objektin në një gjendje që do të jetë i sigurt në afat të gjatë;</p> <p>1.48.Menaxhimi mbetjeve radioaktive - nënkupton të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me përpunimin, para-trajtimin, trajtimin, kondicionimin, ruajtjen ose asgjësimin e mbetjeve radioaktive, duke përjashtuar transportin jashtë vendit;</p> <p>1.49.Mjek i përgjithshëm – nënkupton një mjek, dentist apo profesionist tjetër shëndetësor të emëruar që të mbajë përgjegjësi klinike për një ekspozim individual mjekësor në përputhje me kushtet kombëtare;</p> <p>1.50.Ndërmarrje – nënkupton një person fizik apo juridik që ka përgjegjësi ligjore sipas legjislacionit në fuqi për ushtrimin e një praktike, ka përgjegjësi ligjore për një burim të rrezatimit, ose operon me instalimet bërthamore, përfshirë rastet kur pronari apo mbajtësi i burimit të rrezatimit nuk kryen aktivitete njerëzore të ndërlidhura;</p>	<p>radioactive waste in a disposal facility, including the final engineering or other work required to bring the facility to a condition that will be safe in the long term;</p> <p>1.48.Radioactive waste management - means all activities that relate to handling, pretreatment, treatment, conditioning, storage, or disposal of radioactive waste, excluding off-site transportation;</p> <p>1.49.Practitioner - a medical doctor, dentist or other health professional who is entitled to take clinical responsibility for an individual medical exposure in accordance with national requirements;</p> <p>1.50.Undertaking - a natural or legal person who has legal responsibility under national Law for carrying out a practice, or for a radiation source, or operates nuclear installation, including cases where the owner or holder of a radiation source does not conduct related human activities;</p>	<p>goriva ili radioaktivnog otpada u odlagalište, uključujući završne inženjerske ili druge radove koji su potrebni kako bi se u odlagalištu stvorili uvjete koji su dugoročno sigurni;</p> <p>1.48.Upravljanje radioaktivnim otpadom - znači sve aktivnosti koji se odnose na rukovanje, prethodnu obradu, tretman, skladištenje ili odlaganje radioaktivnog otpada, isključujući njegovo poletanje sa lokacije;</p> <p>1.49.Profesionalni radnik - medicinski doktor, zubar ili drugi zdravstveni profesionalac koji ima pravo da preuzme kliničku odgovornost za medicinsko izlaganje zračenju pojedinaca u skladu sa nacionalnim uslovima zakonodavstva;</p> <p>1.50.Preduzeće – fizičko ili pravno lice koje ima zakonsku odgovornost prema nacionalnom zakonu da vrši praktičan rad, ili za izvor radijacije uključujući i slučajeve gde vlasnik ili korisnik izvora radijacije ne obavlja povezane ljudske aktivnosti;</p>
--	---	--

<p>1.51.Nivel përjashtimi - nënkupton një vlerë të shprehur në terme të përqendrimit të aktivitetit ose të aktivitetit total në ose nën të cilën një burim rrezatimi nuk i nënshtrohet njoftimit ose autorizimit;</p> <p>1.52.Nivel reference - nënkupton nivelin e dozës efektive ose të dozës ekuivalente apo të përqendrimit të aktivitetit në situatë emergjente të ekspozimit ose në situatë ekzistuese të ekspozimit, mbi të cilin nivel konsiderohet i papërshtatshëm lejimi i ekspozimit që ndodh si rezultat i kësaj situatë ekspozimi, edhe pse nuk është një kufi që nuk duhet të tejkalohet;</p> <p>1.53.Nivelet e çlirimit - nënkupton vlerat e shprehura në terme të përqendrimit të aktivitetit, në ose nën të cilat materialet që rrjedhin nga çdo praktikë e cila i nënshtrohet njoftimit ose autorizimit mund të lirohen nga dispozitat e këtij ligji;</p> <p>1.54.Njoftim - nënkupton dorëzimin e informacionit të Agjencisë në mënyrë që të njoftojë për qëllimin e kryerjes së aktiviteteve brenda fushëveprimit të këtij Ligji;</p>	<p>1.51.Exemption level - a value expressed in terms of activity concentration or total activity at or below which a radiation source is not subject to notification or authorisation;</p> <p>1.52.Reference level - in an emergency exposure situation or in an existing exposure situation, the level of effective dose or equivalent dose or activity concentration above which it is judged inappropriate to allow exposures to occur as a result of that exposure situation, even though it is not a limit that may not be exceeded;</p> <p>1.53.Clearance levels - values expressed in terms of activity concentrations, at or below which materials arising from any practice subject to notification or authorisation may be released from the provisions of this Law;</p> <p>1.54.Notification - submission of information to the Agency to notify the intention to carry out a practice within the scope of this Law;</p>	<p>1.51.Nivo izuzeća – vrednost iskazana terminima koncentracije aktivnosti ili ukupne aktivnosti na ili ispod koje izvor radijacije nije podložan notifikacijama ili autorizaciji;</p> <p>1.52.Referentni nivo – prilikom situacije vanredne izloženosti ili u postojećoj situaciji izloženosti, nivo efektivne doze ili ekvivalentne doze ili aktivnosti u koncentraciji iznad koje se smatra neprikladnim da se dozvoli izloženost koja je rezultat takve situacije, čak i ako to nije limit koji ne sme da se pređe;</p> <p>1.53.Nivoi dozvoljenog odstupanja – vrednosti iskazane u terminima koncentracije aktivnosti, na ili ispod onoga što materijali koji nastaju iz delatnosti za koju je potrebna notifikacija ili autorizacija mogu otpustiti, u skladu sa odredbama zakona;</p> <p>1.54.Notifikacija (obaveštenje) – podnošenje informacije Agenciji radi obaveštavanja o nameri da se izvrši radnja u okviru delokruga ovog zakona;</p>
---	---	--

<p>1.55.Objekt i depozitimit - nënkupton çdo objekt ose instalim qëllimi kryesor i të cilit është depozitimi i mbetjeve radioaktive;</p> <p>1.56.Objekt për menaxhimin e mbetjeve radioaktive - nënkupton çdo impiant ose instalim qëllimi kryesor i të cilit është menaxhimi i mbetjeve radioaktive;</p> <p>1.57.Pjesëtarë të publikut - nënkupton individë të cilët mund të jenë subjekt i ekspozimit publik;</p> <p>1.58.Plan i reagimit ndaj emergjencave - nënkupton masat e planifikimit për reagim adekuat në rast të një situatë emergjente të ekspozimit në bazë të ngjarjeve të supozuara dhe skenarëve të ndërlidhur;</p> <p>1.59.Praktikant - nënkupton personin i cili është duke marrë trajnime apo udhëzime brenda një ndërmarrjeje me qëllim të ushtrimit të një aftësie të veçantë;</p> <p>1.60.Praktikë - nënkupton aktivitetin njerëzor që mund të rrisë ekspozimin e individëve ndaj rrezatimit nga një burim i rrezatimit dhe që menaxhohet si një situatë ekspozimi e planifikuar;</p>	<p>1.55.Disposal facility - means any facility or installation the primary purpose of which is radioactive waste disposal;</p> <p>1.56.Radioactive waste management facility - means any facility or installation the primary purpose of which is radioactive waste management;</p> <p>1.57.Members of the public - individuals who may be subject to public exposure;</p> <p>1.58.Emergency response plan - arrangements to plan for adequate response in the event of an emergency exposure situation on the basis of postulated events and related scenarios;</p> <p>1.59.Apprentice - a person receiving training or instruction within an undertaking with a view to exercising a specific skill;</p> <p>1.60.Practice - a human activity that can increase the exposure of individuals to radiation from a radiation source and is managed as a planned exposure situation;</p>	<p>1.55.Odlagališta - znači objekt ili postrojenje čija je primarna svrha upravljanje radioaktivnim otpadom;</p> <p>1.56.Postrojenje za upravljanje radioaktivnim otpadom - znači objekt ili postrojenje čija je primarna namjena odlaganje radioaktivnog otpada;</p> <p>1.57.Gradani (javnost) – pojedinci koji mogu podložni javnoj izloženosti;</p> <p>1.58.Plan hitnog reagovanja - aranžmani da se planira adekvatno reagovanje u slučaju vanredne i hitne izloženosti na osnovu pred postavljenih događaja i odgovarajućih scenarija;</p> <p>1.59.Stażista – osoba koja dobija obuku ili instrukcije unutar preduzeće, sa osvrtnom na uvežbavanje specifičnih veština;</p> <p>1.60.Delatnost – ljudska aktivnost koja može uvećati izloženost pojedinaca radijaciji iz izvora radijacije i njome se upravlja u skladu sa planiranom situacijom izloženosti;</p>
--	---	---

